



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:054944

Datë: 30.06.2023

Numri i dokumentit: 04443003

PKR Nr. 12/23

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË, Departamenti I Krimeve të Rënda**, trupi gjykues në përbërje prej: Kryetarit të trupit gjykues Murat Hulaj dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtaret profesionist Arben Mustafaj dhe Ajshe Balaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale, kundër të pandehurit H. H. nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar se, ka kryer veprën penale, **“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse”** nga neni 364 par.1 të KPRK-së, e duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nën shenjen PP/I Nr. 94/2022 e dt. 15.11.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor, me dt. 23.06.2023, në prezencën e Prokurores së Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit H. H. dhe mbrojtësit të tij av. Salih Mekaj sipas autorizimit, si dhe pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim, me dt. 27.06.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 30.06.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

**I akuzuari:**

**H. H.**, i biri Sh. dhe nënës Gj. e gjinisë S., i lindur me dt ..... në Pejë, me vendbanim në rr.”B. L.” dhe në fsh. R. rr.”H. M.” pn, i identifikuar me nr. personal ....., punëtor në parking, bashkëjeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon nr. të telefonit 049-....-..., me pare i p dënuar, shqiptar shtetas i Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt.25.08.2022 e gjerë me dt.25.10.2022, tani gjendet në liri.

**Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së,**

**LIROHET NGA AKUZA**

**Gjëja së:**

Gjatë vitit 2022 e në vazhdimësi, në Pejë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, i pandehuri ka blerë dhe ka shitur armë, në atë mënyrë që i pandehuri derisa ka qenë duke punuar në parkingun e R. C. “M.”, i njëjti ka blerë armë nga persona të ndryshëm me çmim prej 150 euro për një armë, ashtu që të njëjtat me pas ju ka shitur personave që kanë qenë të interesuar për me ble e kryesisht mërgimtarëve në shumë prej 250 euro për një armë.

-me çka kishte për të kryer veprën penale, **“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armeve apo materialeve plasëse”** nga neni 364 par.1 të KPRK-së

**Pasi që me asnjë provë, nuk është vërtetuar se, e njëjta ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.**

**Shpenzimet e procedurës penale bien në barre të mjeteve buxhetore.**

## Ar sy e t i m

### Historiku i çështjes

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me dt. 15.11.2022 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 94/2022, kundër të pandehurit H. H. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se, ka kryer veprën penale, **“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armeve apo materialeve plasëse”** nga neni 364 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit Sh. H. dhe K. N. për shkak se të njëjtit secili veç e veç kanë kryer vepra penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda me dt. 20.01.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosa, i pandehuri H. H. si dhe mbrojtësi i tij av. Sali Meka, sipas autorizimit, Sh. H. së bashku me mbrojtësin e tij Asdren Mekaj dhe i akuzuari K. N..

Në këtë seance të shqyrtimit fillestar, pas njoftimit të akuzuarve me të drejtat dhe detyrimet ligjore që ju takojnë në procedurën penale, sipas Kodit të procedurës penale, si dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurorja e Shtetit, dhe pasi që gjykata, është bindur se të njëjtit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtit ju ka dhënë mundësi secilit veç e veç që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, ku i akuzuari H. H., ka deklaruar se nuk ndihet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa të akuzuarit Sh. H. dhe K.N.secili veç e veç kanë deklaruar se i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranojnë fajësinë, për veprat penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Vlen të ceket se kryetari i trupit gjykues pas propozimit të mbrojtësit të pandehurit Sh. H., av. Asdren Mekaj dhe deklarimit të palëve në procedurë, ka marr aktvendim procedural që të veçohet procedura penale kundër të pandehurit H. H. për veprën penale **“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armeve apo materialeve plasëse”**, nga neni 364 par.1 të KPRK-së, dhe e njëjta është regjistruar me numër të ri të lëndes PKR.nr.12/23.

Pas kësaj, gjykata të njëjtit dhe mbrojtësin e tij i ka njoftuar se, në afat prej 30 ditësh nga mbajtja e seancës së shqyrtimit fillestar, ka të drejtë të paraqes kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhje të aktakuzës, si dhe propozime tjera, ndërsa për kundërshtimet dhe kërkesat eventuale gjykata nuk do të mbaje seancën e shqyrtimit të dytë, dhe për kërkesat do të vendose jashtë seancës.

**Kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës**

Mbrojtësi i të pandehurit av. Salih Mekaj në afatin ligjor, me dt. 16.02.2023, ka parashtruar kërkesën për hedhje të aktakuzës, duke i propozuar gjykatës që të hedhet aktakuza, për faktin se nuk ka prova përmes të cilave do të vërtetoheshin faktet relevante për përgjegjësinë penale dhe fajësinë e të pandehurit, mungesa e çfarëdo prove që do të vërtetonte se sa armë i ka bere i pandehuri, kur i bleu dhe kujë ia shiti, është e pamundur që kjo akuze të trajtohet seriozisht sepse nuk përmban as minimumin e kushteve të domosdoshme për ekzistimin e dyshimit të bazuar siç kërkohet me ligj.

Gjykata menjëherë pas pranimit të kërkesës për hedhjen e aktakuzës, nga një kopje i ka dërguar Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamentit për krime të rënda. Prokurori i shtetit nuk ka dhënë përgjigje me shkrim, lidhur me kërkesën për hedhjen e aktakuzës nga mbrojtësi i lartcekur, edhe pse ka qenë i njoftuar.

Pas kësaj, gjykata me dt. 20.03.2023, ka marrë Aktvendim me të cilin ka refuzuar kërkesën për kërkesën e hudhjes së aktakuzës të ushtruar nga ana e mbrojtësit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me kërkesën për hedhje të aktakuzës, duke vlerësuar se nuk ka argumente bindëse se vepra penale për të cilat ngarkohet i akuzuari nuk janë të bazuar dhe po ashtu duke theksuar se në këtë fazë të procedurës penale ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet.

### **Shqyrtimi kryesor**

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor në këtë çështje penale me dt. 16.05.2023 në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri H. H. si dhe mbrojtësi i tij av. Sherif Malushaj sipas autorizimit zëvendësues. Në këtë seance të pandehurit prapë i janë komunikuar të drejtat e tij ligjore që burojnë nga Kodi i Procedurës Penale, i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe për mbrojtës e pranon av. Sherif Malushaj sipas autorizimit zëvendësues nga mbrojtësi i tij kryesor av. Salih Mekaj, me të njëjtin janë konsultuar paraprakisht dhe nuk kanë nevojë për konsultime shtese.

Pas konstatimit të aktakuzës si e lexuar, të pandehurit prapë i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë, ashtu që i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për këtë vepër penale.

Si rrjedhojë e kësaj, gjykata ka kaluar në fazën e administrimit të provave dhe ka ftuar palët për dhënien e fjalës hyrëse.

Prokurorja e shtetit në Prokurorinë Themelore në Pejë, në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor do të administrohen provat materiale të konstatuara ne aktakuzën e Prokurorisë e ne veçanti raportet e masave të fshehta siç janë monitorim i fshehte të bisedave ne vende private dhe fotografim i fshehte ose vëzhgim me video ne vende private raportet e ekspertizës, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, me pas do të dëgjohet edhe vet i pandehuri ashtu që pas administrimit të këtyre provave gjykata do të bindet se i pandehuri H. H. ka kryer veprën penale ne vend, kohe dhe mënyre të përshkruar si ne dispozitivin e aktakuzës.*

Mbrojtësi i te pandehurës, av. Sherif Malushaj në fjalën hyrëse ka përpiluar fjalën hyrëse me shkrim, të njëjtën e dorëzoi ne kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe Prokurorin e shtetit dhe e njëjta të jete pjesa përbërëse e shkresave të lëndës, dhe heqi dore nga elaborimi i saj.

I pandehuri H. H. në fjalën hyrëse ka deklaruar se: *unë pajtohem në tërësi me fjalën hyrëse të avokatit tim të dorëzuar me shkrim, nuk kam çka të shtoj më shumë.*

### **Administrimi i provave formale – materiale**

Në seancën e vazhdimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor të mbajtur me dt. 23.06.2023, janë administruar provat materiale – formale me sa vijon: *Raport i kontrollit të banesës së pandehurit Sh. H. dt.25.08.2022 me nr.2022-DH.-..., vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 25.08.2022, e lëshuar në emër të Sh. H.; Raporti i tretë 15 ditor “Monitorim të Fshehtë të Bisedave në vende private dhe fotografim i fshehtë ose vëzhgimi me video në vende private” për periudhën kohore të dt. 06.05.2022 e gjerë me dt. 20.05.2022; Raporti i tretë 15 ditor “monitorim të fshehtë të bisedave në vende private dhe fotografim i fshehtë ose vëzhgimi me video në vende private”, përfshire periudhën kohore 21.05.2022 gjerë me dt. 04.06.2022; raporti njoftues lidhur me raportin e ekspertizës me nr. 04...-. dt.03.10.2022, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me foto albumin e vendit të ngjarjes, raporti i ekzaminimit balistik të armëve me nr. AKF/2022-.../22-.....*

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

I pandehuri H. H., me dt. 23.06.2023 është ftuar për të dhënë mbrojtjen e tij, ka deklaruar se *i ka kuptuar të drejtat e tij, nuk ka nevojë për konsultim të serishëm me mbrojtësin e tij pasi që është konsultuar paraprakisht dhe dëshiron të shfrytëzon të drejtën e ti që të mbrohet në heshtje.*

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Prokurorja e Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit H. H. i akuzuar për vepër penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 par. 1 të KPRK-së dhe atë pas administrimit të provave siç janë raporti i kontrollit të banesës së tani të dënuarit Sh. H. këtu babait të të akuzuarit të dt. 25.08.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 25.08.2022 e lëshuar në emër të tani dënuarit Sh. H. edhe pse mbrojtja në raport me këto prova mund të deklaroi së për të njëjtat është akuzuar dhe dënuar babai i të pandehurit H. H., mirëpo nëse i analizojmë edhe raportet e masave të fshehta ju do të vërtetoni lidhjen kauzale në mes të veprimeve të të pandehurit H. H. dhe me veprimet e të tani të dënuarit Sh. H.. Nga raporti i masave të fshehta dhe atë të dt. 06.06.2022 i cili ka të bëjë me raportin e trete 15-ditor është vërtetuar së bisedat e zhvilluara me dt. 26.05.2022 rreth orës 22:40 i pandehuri H. H. bisedon me një person mashkull i pa njohur “PPM” në kabinën e parkingut rent a car “M.” në Pejë e në të cilën bisede i pandehuri H. i drejtohet “i kam pas një paket plumba qesi me gaz” kurse ky person i panjohur ja kthen “fillon me numërimin e plumbave 6, 7, 8” kurse i pandehuri H. “jo jo tash unë... me tutje nuk kuptohet” ky personi i panjohur i thotë të pandehurit H. “u kry” kurse i pandehuri H. i thotë “maji qeto hekra kur mi pruni një nate me kallxoi që e ka qit (gjuajt) qatë paket a e din.” Personi PPM i thotë po de diçka të vogël kishe i ka qit” i pandehuri h i thot “po 2, 3, 4, 5, 45 i ki qetu edhe tash hajt se prej largi folim tani. Kur po shkoj në banesë i kish haru dy karikator të sigit (sig model i armës) në çantë të unë, pe thirri pe zajabati thash u bom 00 tha he qysh thash qeshtu, qeshtu i ke haru sendet e tua, sonte thash pi ja bon Pajta tha ja ka nis zemra sigit duhet me ardh ne orman apët se apët, po ja bon atij një ofertë e ki kur dush tash merre, i thash hajt bre daj se u bo, malli u bo, vlera e shtrenjte, problem me blloku shumë pare, thash hajt se qysh ja ki nis bima qat sig edhe 20 euro që svjen unë ti jepi thash”*

Po ashtu vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është vërtetuar nga raporti i trete i vëzhgimit "vëzhgimi i fshehte me video ne vende publike përfshirë periudhën kohore 21.05.2022 deri 06.06.2022 nga i cili raport janë vërtetuar disa rrethana relevante ku me dt. 21.05.2022 rreth orës 14:30 minuta një person NN kishte shkuar ne lokacionin ku punon i pandehuri H. H. të cilit i tregon ka qenë, e këqyra atë ( në banesën e tij) dhe fishek nuk kishte, ( arma automatike sig sauer) pasi që personi NN largohet nga parkingu R. "M.", i pandehuri vazhdon bisedën me gruan e tij D. H. dhe thotë, i thash bjerë atë me dy karikator. Këto fakte të vërtetuara nga raportet e masave të fshehta i ka pranuar edhe vet i pandehuri H. H. në deklaratat e tij të dhëna ne polici dhe ne prokurori e të cilat si pa të drejte gjykata i refuzoi ne kundërshtim me nenin 119 par. 5 të KPPRK-së i cili një propozim të tillë ligji e lejon.

Se i pandehuri H. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet e provojnë edhe raportet policore, raporti i këqyrjes të vendit të ngjarjes, foto albumi i vendit të ngjarjes por edhe raportet për ekzaminimin balistik të armeve edhe pse armët si të tij i ka pranuar i dënuari Sh. H. mirëpo bazuar ne raportet e masave të fshehta e ne veçanti bazuar ne gjendjen shëndetësore të vet të dënuarit Sh. H., por edhe me deklarinimin e P. H. i është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri H. H. është marrë me shitblerjen e armeve ashtu siç ka deklaruar vet dhe ka pranuar vet si ne polici ashtu edhe ne prokurori, që ai e ka ble dhe shit vetëm arme me gaz, edhe pse i njëjti sot ne shqyrtimin gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes së heshtje. Mbrojtja sigurisht që do të thirret ne faktin kur ska armë ska vepër, e që në realitet në kemi edhe armët , i kemi edhe masat e fshehta e kemi edhe vendin ku është arritur marrëveshje ne mes të pandehurit me klientët që kanë qenë të interesuar për blerje apo shitje.

Andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin të shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet sipas ligjit, të dënon sipas ligjit si dhe ta obligon ne paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, kurse me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim i propozoj gjykatës që si rrethana renduese të vlerësoje dashjen e të pandehurit për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, kurse si rrethana lehtësues ne këtë rast Prokuroria nuk ka gjetura.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Salih Mekaj, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: kjo aktakuzë për shkak të parregullsive të saj nuk është dashtë fare të vije ne shqyrtim gjyqësor, mirëpo meqenëse jemi këtu dua të theksoj se aktakuza është përpiluar ne kundërshtim me ligjin sepse nuk e ka përcaktuar qarte kohen e kryerjes së veprës penale, madje as për afërsisht nuk e ka përshkruar objektin e veprës penale dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Nga provat e administruara nuk u vërtetua ne asnjë mënyre dashja e të pandehurit për blerje të armeve me qëllim të shitjes, ndërkaq një komunikim telefonik që flet për disa fishek nuk është argument që ato janë blere për të shitur, sepse në aktakuzë nuk thuhet se ka blere kaq fishek, e ka shit personit caktuar kaq për çmimin e caktuar, mënyra se si është formular aktakuza është tejet abstrakte sepse thuhet gjatë vitit 2022 ne vazhdimësi, deri kur ne vazhdimësi, viti 2022 i ka 12 muaj. Pastaj thahet se ka blere dhe ka shit armët, po nuk thuhet se cilat dhe sa arme thuhet se ka blere nga personat e ndryshme por nuk thuhet asnjë person i vetëm nga i cili është blere qofte një arme dhe se fundi thuhet se ju ka shit armët personave të ndryshëm por nuk thuhet se paku një person të cilit i është shitur arma apo mjet i cili sipas ligjit konsiderohet si arme. Se dyti Prokurorja përpiqet që përmes një raporti të sekuestrimit të armeve në shtëpinë e tani të ndjerit Shefqet Hyseni që këto armët i atribuojnë të pandehurit H. H., nuk është thënë ne dispozitivin e aktakuzës për H. H. se këto arme a ka blere apo i ka shit. I akuzuari H. H. nuk është akuzuar për bashkëkryerje me të atin e tij, për posedim apo kontroll të armeve që janë gjet ne shtëpinë e Sh. H., qoftë si bashkë kryes apo si kryes i vetëm. Tani është e palejueshme që të pretendohet së i akuzuari kishte lidhje me ato arme. Lidhja e gjakut me tani të ndjerin Sh. H. nuk e bën bashkëpjesëmarrës me të akuzuarin Sh. H. sepse armët janë gjete ne shtëpi të veçante që e ka shfrytëzuar Sh. H. dhe jo H. H.. Nuk kemi asnjë prove dhe asnjë dëshmi që tregon lidhjen kauzale

*ne mes të shitblerjes së armeve dhe armeve që janë gjet ne shtëpinë e Sh. H.. Nga raporti i përgjimit telefonike kemi vetëm një thirrje të porealizuar të akuzuarit H. H. për blerjen e një arme të vetme e cila nuk është realizuar siç rezulton edhe nga vet raporti i përgjimeve telefonike. Prandaj ne mungese të provave konsideroj së nuk është vërtetuar asnjë nga elementet e veprës penale për të cilën dyshohet i akuzuari e që do të oshte blerja ose shitja e ndonjë arme. Unë konsideroj së deklarimi i të pandehurit pavarësisht nga rrethanat në të cilat është dhënë, nuk mund të shërbeje vetëm si provë për të shpall të akuzuarin fajtor ose për ta bazuar aktgjykimin në këtë deklarinimin e tij.*

*Për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet që veprimi i blerjes dhe shitjes të jenë të konkretizuara, të jene veprimet e kryera sepse ne aktakuzë thuhet ka shit dhe ka blere por këto veprim nuk u vërtetuan me asnjë prove kredibile. Nga këto arsye unë i propozoj gjykatës që të pandehurin të liroje nga akuza ne mungese të provave. Prokurorja dukë vepruar ne përputhje me ligjin e ka propozuar rrethanat renduese por ato që i propozoi prokurorja nuk janë rrethana renduese sepse janë elemente konstitutive të veprës penale, pra dashja për kryerjen e veprës nuk mund të jete rrethana renduese sepse pa dashje nuk mund të ketë vepër penale dhe se dyti rrezikshmëria shoqërorë e veprës penale, edhe kjo është element përbërës i figurës së secilës vepër penale dhe nuk mund të merret si rrethane renduese. Unë këto i përmendi vetëm që gjykata të këtë parasysh por pretendimi im është se nuk është vërtetuar fajësia e të mbrojturit tim.*

I akuzuara H. H., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: *e mbështes në tërësi deklarinimin e mbrojtësit tim, nuk kam çka të shtoj më shumë.*

**Andaj, pas administrimit të provave materiale – formale siç janë: gjykata ka ardhur në përfundim se me asnjë prove dhe assesi nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.**

### **Vlerësimi i provave materiale – formale**

Gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, është vërtetuar dhe argumentuar me faktet, respektivisht provat formale – materiale të cilat u administruar gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor, si në vijim:

- Nga Raport i kontrollit te banesës se te pandehurit Sh. H. dt.25.08.2022 me nr.2022-D.-..., ku vërtetohet se gjate kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit janë gjetur dhe sekuestruar : një automatik A-. numër serik ....; dy karikatorë për te njëjtën arme; një revole me gaz –Z. . mm, me numër serik ...; Gjashte fishek me gaz të zbrazet cal 7... mm; Një revole B.TR-.me gaz . mm, numër serik B...-...; Një karikatorë për të njëjtën armë; 41 cope fishek me gaz . mm; 60 cop fishek cal ....×.mm; 3 doreza (kontakt) për arme të gjata; 9 pjesë shtese për armen A...; Një tromblonike.
- Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve te dt. 25.08.2022, i lëshuar ne emër te Sh. H. ku vërtetohet se janë sekuestruar përkohësisht : Një automatik AK-.numër serik ...; Dy karikatorë AK-...; Një revole me gaz –Z. . mm, me numër serik ...; Gjashte fishek me gaz të zbrazet cal. ... mm; Një revole B. TR-. me gaz . mm, numër serik B...-...; Një karikatorë . mm; 41 fishek me gaz .mm; 60 fishek cal ....×.mm për AK-...; 3 doreza për AK-...; 9 pjesë shtese për armen AK...; Një mini tromblonike.
- Nga Raporti i tretë 15 ditor “Monitorim te Fshehtë te Bisedave ne vende private dhe fotografim i fshehtë ose vëzhgimi me video ne vende private” për periudhën kohore të dt. 06.05.2022 e gjerë me dt. 20.05.2022, nga i cili raport vërtetohet se me dt.21.05.2022

rreth orës 15:23:15, fillon biseda ne mes të një personi mashkull i pa njohur “PPM” dhe të pandehurit H. H. në kabinën e parkingut R. C. “M. në Pejë”, citoj bisedën PMMi: I qon mi kqyr rasha bon me ti kthy, jo pa ta q.. nanen kqyri qaty kuti duhet me kan, fishek nuk kish, H.: Hiq a. PPM:jo, qy ku e li karikatorin ja hejek i ka vy diçka po ta bi kta tvoglin. H.: qy kjo firm e ktyre alltijav. PPM: po glanc e re vlla. H.: sikur aja tjetra qe e kam marr e vogla po edhe ma simpatike. PMM: Ishalla ja sheh hajrin. H.: Tlumt goja, ani kqyr nder kohe kur te shihesh me ta ta bjen qata. PMM: Po ta bjen ata. pasi që përfundon biseda me PMM i pandehuri vazhdon bisedën me gruan e tij dhe thotë, i thash bjerë atë me dy karikator.

- Nga raporti i tretë 15 ditor “monitorim te fshehtë te bisedave ne vende private dhe fotografim i fshehtë ose vëzhgimi me video ne vende private”, përfshire periudhën kohore 21.05.2022 gjerë me dt. 04.06.2022 nga i cili raport vërtetohet se me dt. 26.05.2022 rreth orës 22:00:43:40, fillon biseda ne mes te pandehurit H. H. dhe një personi mashkull i pa njohur “PPM” në kabinën e parkingut R. C, “M. në Pejë”, citoj bisedën H.: I kom pas 1 paketë plumat qesi me gaz. PPM: Po. PPM: Fillon numërimin e plumbave 6,7,8. Hyseni: Jo, jo tash unë (nuk kuptohet). PPM: U kry. H.: Maj qeto hekra, kur mi pruni ni natë me kallxoj qe e ka qitë (gjuajt) qatë paketë a e din. PPM: Po de diçka te vogël kishe i ka qit. H.: Po 2,3,4, 5 dhe 45 i ki qetu edhe tash hajt se prej largi folim tani. Kur po shkoj ne banesë i kish harru dy karikator tjerë te sigit të vet (sig model i armës) në çantë te unë, pe thirri pe zajabati thash u bom zero zero tha he qysh thash qeshtu, qeshtu i ke harru sendet e tua, sonte thash pi ja bon P. tha ia ka ni zemra S. duhet me ardh në ormon apët se apet, po ja bon atij një oferte e ki pet kur dush tash merre, thash hajt bre daj se u bo, malli u bo vlera e shtrenjtë problem me blloku shumë pare, i thash hajt bre daj se qysh ja ke nis bima qat sig edhe një 20 euro qe svjen unë ti japi thash”.
- Nga raporti njoftues lidhur me raportin e ekspertizës me nr. ....-22 dt.03.10.2022, ku vërtetohet se pas ekzaminimit te dëshmime D#1 telefon Iphone dhe dëshminë D#2 një telefon Samsung, nuk ka rezultuar me gjetjen e ndonjë fotografie, SMS apo ndonjë provë qe lidhet me vepra penale për te cilat janë hetuar te pandehurit apo ndonjë vepër tjetër penale.
- Nga raporti këqyrjes se vendit te ngjarjes se bashku me foto albumin e vendit i ngjarjes të policit hetues T. H. i dt. 25.08.2022 nën shenjen 2022-DH.-..., ku janë përshkruar të gjitha veprimet e daljes ne vendin e ngjarjes ku prezent ka qenë edhe zyrtari i teknikes-kriminalistike nga st. Policor Pejë B. P., ku vërtetohet se pas bastisjes në shtëpinë e Sh. H.në fshatin R.janë gjetur arme dhe municion i ndryshëm # 1. Disa pjesëve shtese për AK.... #1/1. Një predhe trombolike e cila është tërhequr nga njësit i... #2. Pushke automatike AK-..., kal.7...×...mm, së bashku me dy karikator të AK-... #3. Revolver me gaz i markës “Z.” kal..mm si dhe . gëzhjoja me gaz të kalibrit .mm të cilat ishin brenda një pakoje plastike. #4 Pistoletë me gaz e markës “B..” e lolit “T.” së bashku me karikator brenda saj, me.. fishek me gaz brenda një pakoje plastike ku ishte edhe një pajisje për pastrim të armës. #5. Gjashtëdhjetë (60) fishekëve të kalibrit ....×.. mm, të evidentuar me numër #5, e të cilat janë sekuestruar.
- Si dhe foto albumi shihet vendi ku ka ndodhur ngjarja ditën kritike (foto 1,2,3, 4,9,10,11, 17 dhe 18), shihet pamja e jashtme e shtëpisë dhe pamja e brendshme e shtëpisë të dyshuarit Sh. H. (foto 5) , shihet pamja e dëshmime te gjetura brenda një qese plasmasi, (foto 6) shihet pamja e dëshmisë #1 dhe #1/1, (foto 7) shihet pamja e disa pjesëve shtese për AK-47 të evidentuara me nurin #1 të dëshmisë, (foto 8) shihet pamja e një bredhë trombolike e evidentuar me numrin #1/1 të dëshmisë, (foto 12) shihet pamja e dëshmime

brenda dhomës së lartcekur, (foto 13) shihet pamja e dëshmime të evidentuar me numër rendor, (foto 14) shihet pamja e AK-..., kal.....x.. mm së bashku me dy karikator të AK-..., (foto 15) shihet pamja e një revolveri me gaz i markës “Z.” kal.9mm, si dhe gëzhjojave me gaz të kalibrit 9mm, të cilat ishin brenda një pako plastike, (foto 16) shihet pamja e një pistolette me gaz e markës “B.” e llojit “T...” së bashku me karikator brenda saj, me 41 fishek me gaz, brenda një pakoje plastike ku ishte edhe një pajisje për pastrim të armës, (foto 19) shihet një orman brenda dhomës ku mbi te është gjetur një pako me fishek, (foto 20) shihet pamja e fishekëve të paketuara me letër – ngjithëse ngjyre të kaftë, (foto 21) po ashtu shihen 60 fishek të kalibrit ... × ..mm, të evidentuara me numër rendor #5.

- Nga raporti i ekzaminimit balistik të armëve me nr.AKF/2022-.../22-..., të dt. 14.11.2022, vërtetohet se dëshmia e evidentuar me D shifër #1, janë: a)Një (1) pushkë automatike ASH-.. Tipi 3 version i AK-.. i kalibrit ....x.. mm me numër serik ...- ... Arma ka qenë e çmontuar pa shule, pa bartës të shulit, pa sustë rikthyese, si dhe pa dhomë të gazrave (qe të gjitha kanë qenë në të njëjtin paketim). Armës i mungon kondaku i drurit. Arma është funksionale.  
b)Dy (2) karikator të zbrazet me kapacitet prej tridhjetë (30) fishekëve të dizajnuar për pushke automatike AK-.. te kalibrit 7...x..mm.  
Dëshmitë e evidentuara D#2 janë: Gjashtë dhjetë (60) fishekë të kalibrit 7...x..mm.  
Dëshmitë e evidentuara D#3 janë: Tre (3) kondak të drurit për armët <sup>3</sup>ASH-.. njëri prej tyre është i dëmtuar, ndërsa njërit i mungon pjesa metalike qe vendoset në fund te kondakut.  
Dëshmitë e evidentuara D#4 janë: a) Dy (2) pjesa metalike qe vendosen në fund te kondakut të armës ASH-... Një dorezë e drurit për armët ASH-...Konstatimi dhe mendimi përfundimtar: Shenjat e gjilpërës goditëse të armës të gëzhojat e kalibrit 9mm gaz VN-T. Shenjat e gjilpërës goditëse të armës të gëzhojat e kalibrit 9mm gaz VN-T. c) Tri (3) pjesë të drurit te cilat e mbulojnë tytën dhe dhomën e gazrave të armës ASH-...Tri (3) pjesë metalike të cilat shërbejnë për ta vendosë rripin për mbajtjen e armës.  
Dëshmia e evidentuar D#6 janë : Një (1) revolver Z.. model R2 ... i kalibrit 9mm gaz me numër serik ...-... me gjashtë (6) fole. Arma ka pjesën shtesë për te përdor fishekë sinjalizues. Arma është funksionale.  
Dëshmitë e evidentuara D#7 janë: Gjashtë (6) gëzhoja pjesë të fishekëve të kalibrit 9mm gaz, ( në përshkrim te hetuesit thuhet gjashtë (6) fishekë ...mm). Gëzhojat janë gjuajtur (shkrepur) nga revolveri Z. model R2 ... me numër serik ...-... e sjellë nga dëshmia D#6.  
Dëshmitë e evidentuara D#8 janë: a) Një (1) pistoletë B... model TR .. e kalibrit 9mm gaz me numër serik B...-.... Arma ka pjesën shtesë për te përdor fishekë sinjalizues. Arma është funksionale. b) Një (1) karikator i zbrazet me kapacitet prej shtatëmbëdhjetë (17) fishekëve i dizajnuar për pistoletat e gazit B. ´model TR...  
Dëshmitë e evidentuara D#9 janë katër dhjetë e një (41) fishekë të kalibrit 9mm gaz.  
Dëshmia e evidentuar D#10 është një (1) pistoletë E. T. Model... e kalibrit 8mm gaz me numër serik "...-....". Armës i mungon kafka (kompletë me të gjitha pjesët përbërëse te sajë) më gjilpërë goditëse, siguresat si dhe njëra pjesë plastike e mbulesës së dorezës. Arma është e ri dizajnuar qe donë të thotë se kjo pistoletë e gazit është ri dizajnuar (punuar me dorë) dhe është bërë armë e zjarrit e kalibrit ....x..mm . Arma nuk është funksionale(Arma është sekuestruar në shtëpinë e të pandehurit R. D.).  
Dëshmitë e evidentuara D#11 janë: a)Tridhjetë e nëntë (39) fishekë te kalibrit .... mm. b) Dhjetë (10) fishekë te kalibrit 9mm B . Long. c) Tetë (8) fishekë te kalibrit ...mm. d) Katër (4) fishekë te kalibrit ... mm, njëri i therur dhe pa karakteristika Balistike për ekzaminim. e) Tre (3) fishekë te kalibrit .22 L.. f) Dy (2) fishekë te kalibrit ...x..mm. g)



Një (1) fishek i kalibrit .38 S.. h) Një (1) fishek i kalibrit .45 A.. i) Një (1) fishek i kalibrit 7..x...mm.

Dëshmitë e evidentuara D#12 janë: Dy (2) brusha qe shërbejnë për pastrim të armëve dhe një (1) pjesë shtesë qe shërben për zgjatjen e këtyre brushave. b) Dy (2) pjesë metalike te shulit të armës së gjatë A.-.. c) Dy (2) mbulesa të drunjëta të dorezës së armës se pa njohur. d) Një (1) mbulesë e plastikes e dorezës së armës TT-..., T.54etj. e) Një (1) komplet i pajisjeve qe shërbejnë për pastrim të armëve të gjata. f) Një (1) gjilpërë goditëse se bashku me sustën rikthyese e armës se pa njohur. h) Një (1) pjesë metalike qe vendoset te dhoma e gazrave të arma e gjatë A.-78 g) Dy (2) spirale metalike. b) Dy (2) lima.

Dëshmitë e evidentuara D#13 janë: a) Dy (2) karikator të zbrazet me kapacitet prej tridhjetë e pesë (35) fishekëve të dizajnuar për automatiket <sup>3</sup>P.-43´te kalibrit 7...x...mm. b) Një (1) karikator i zbrazet me kapacitet prej tridhjetë (30) fishekëve i dizajnuar për pushkë automatike <sup>3</sup>AK-..´ te kalibrit 7...x...mm. c) Një (1) karikator i zbrazet me kapacitet prej tetë (8) fishekëve i dizajnuar për pistoleta <sup>3</sup>TT-..´<sup>3</sup>Type-54´etj, te kalibrit 7...x...mm, karikator i nuk është funksional.

Dëshmitë e evidentuara D#14 janë: a) Një (1) pistoletë Z. model ..-T e kalibrit . mm gaz me numër serik ....Arma është e ri dizajnuar qe donë të thotë se kjo pistoletë e gazit është ri dizajnuar (punuar me dorë) dhe është bërë armë e zjarrit e kalibrit 7...x...mm Arma është funksionale. Një (1) karikator i zbrazet me kapacitet prej gjashtë (6) fishekëve i dizajnuar për pistoletat e gazit Z. ´ model ...T .

Dëshmitë e evidentuara D#15 janë: Njëzetë e nëntë (29) fishekë te kalibrit 7...x...mm. Nuk është Zbuluar Përputhshmëri me raste të tjera të Librarisë së Rasteve të Hapura.

### Vlerësimi juridik i çështjes

Gjykata rikujton se i pandehuri H. H. akuzohet për veprat penale “*Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armeve apo materialeve plasëse*” nga neni 364 par.1 të KPRK-së.

Neni 364 par. 1 të KPRK-së përcakton së: “*Kushdo që në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatë mijesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) seri në tetë (8) vjet*”.

Nga ky formulim ligjor, mund të kuptohet se veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë alternative; ashtu qe veprën penale e kryen ai qe furnizon, transporton, prodhon, këmben ose shet arme pa autorizim, d.m.th. kushdo që ndërmerr ndonjërin nga këto veprime pa pasur autorizim për një veprim të tillë<sup>1</sup>, që veprimet alternative të përshkruara me sipër të paraqesin veprën penale të parashikuar nga paragraf 1 i neni 327, është e nevojshme që ato të jenë ndërmarrë pa autorizim, ne mënyrë të kundërligjshme, gjë që nënkupton se këto veprime janë ndërmarrë jashtë dispozitave ligjore, pa poseduar leje të caktuara të organit kompetent, (madje kërkohet edhe vetëdija e kryerësve që veprimet po i ndërmarrin pa autorizim).

Pas analizimit të kësaj vepre penale, e në raport me veprën për të cilën akuzohet i pandehuri, gjykata ka ardhur në përfundim se veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në shkelje të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, dhe atë kur dikush importon, eksporton, blen, furnizon transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet arme apo materie

<sup>1</sup>Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija / Dr.Sc. Fejzullah Hasani; *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, fq. 1035, Prishtinë, 2014.*

plasëse ose përfshinë më shumë se katër armë, më shumë se katër materiale plasëse apo më shumë se katërqind fishekë. Kjo është një formë kualifikuese e veprës penale nga neni 364 par. 1 varësisht nga furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimin ose shitjen e të gjitha llojeve të armeve e bën më të rëndë, cilësuese.

#### *Analiza e fakteve kontestuese dhe jo kontestuese*

Qëllimi i gjykimit dhe administrimit të provave materiale dhe personale është gjetja e të vërtetës dhe ndriçimi i plote dhe i saktë të ndonjë çështje apo ndonjë situatë. Mirëpo, në raste të tilla, gjithmonë ekzistojnë rrethana të cilat për gjykatën janë kontestuese, si dhe ato që nuk janë kontestuese.

Për gjykatën nga fillimi nuk ka qenë kontestues fakti se janë gjetur armët dhe sekuestruar në shtëpinë e babit të pandehurit H. H., tani të ndjerit Sh. H. një automatik AK-. numër serik ..-...; dy karikatorë për të njëjtën armë; një revole me gaz -Z. . mm, me numër serik 0.-...; Gjashtë fishek me gaz të zbrazet cal 7... mm; Një revole B.-.. me gaz . mm, numër serik B...-...; Një karikatorë për të njëjtën armë; 41 cope fishek me gaz 9mm; 60 cop fishek cal 7...x...mm; 3 doreza (kontakt) për armë të gjata; 9 pjesë shtese për armen AK..; Një tromblonike, me të cilën gjykata të pandehurin Sh. H. e ka dënuar dhe aktgjykimi nën shenjen PKR.NR.../.., dhe është bërë i plotfuqishëm.

Po ashtu për gjykatën në këtë çështje penale asnjëherë nuk ka qenë kontestues fakti se i pandehuri ka punuar në parkingun e R.C. "M..

Për gjykatën kanë qenë kontestuese rrethanat së i pandehuri H. H. a ka blerë dhe a ka shitur armë, derisa ka qenë duke punuar në parkingun e R.C. "M.?"

Gjykata pas analizimit të të gjitha provave që janë administruar gjatë këtij shqyrtimi kryesor, ka gjetur se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i pandehuri ka ndërmarrë këto veprime inkriminuese për të cilat akuzohet sipas prokurorisë. Gjykata në raport me këto veprime për të cilat i pandehuri ngarkohet sipas aktit akuzues, nuk ka mundur të vërtetojë as me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës pasi që në raportin e kontrollit të banesës së të pandehurit Sh. H. dt.25.08.2022 me nr.2022-DH.-... ku vërtetohet se gjatë kontrollit në shtëpinë e të njëjtit janë gjetur dhe sekuestruar armët e lartë përmendura dhe nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 25.08.2022, i lëshuar në emër të Sh. H. ku vërtetohet se janë sekuestruar përkohësisht armët, lidhur me këto i pandehuri Sh. H. ka pranuar fajësinë dhe nga kjo gjykate është dënuar sipas aktgjykimit nën shenjen PKR NR.../.. i dt. 14.02.2023 i cili është bërë i formës së prere, po ashtu edhe nga raporti njoftues lidhur me raportin e ekspertizës me nr. 0.-22 dt.03.10.2022, ku vërtetohet se pas ekzaminimit të dëshmitë D#1 telefon Iphone dhe dëshmitë D#2 një telefon Samsung, nuk ka rezultuar me gjetjen e ndonjë fotografie, SMS apo ndonjë provë që lidhet me vepra penale për të cilat janë hetuar të pandehurit apo ndonjë vepër tjetër penale.

Përfundimisht, gjykata ka gjetur së me këto prova, të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri nuk mund të lidhet me veprimin e kryerjes së kësaj vepre penale, ashtu siç e ngarkon akuza, *së gjatë vitit 2022 e në vazhdimësi ka shitur dhe ka blerë armët...* pasi që me asnjë provë nuk është provuar ndërmarrja e veprimeve inkriminuese nga ana e të pandehurit siç është elaboruar më lartë, e po ashtu nuk është vërtetuar se i pandehuri a ka shitur ose a ka blerë armë, nuk është gjetur as personi të cilit ia ka shitur armen ose nga i cili ka blerë armen, nuk dihet lloji i armës i cili ka qenë në "qarkullim" dhe as çmimi i armeve gjëja të shitura apo të

blera, dhe nuk kishte as ndonjë dëshmitar i cili kishte dëshmuar për shitblerjen e kryer, për armen e pranuar apo e dorëzuar apo për ndonjë shumë të hollave të pranuar nga shitblerja e armëve.

Në këtë vend, vlen të theksohet së pasi që i pandehuri H. H., i ftuar për të dhënë mbrojtjen e tij, pas konsultimit me mbrojtësin tij ka deklaruar së dëshiron të shfrytëzon të drejtein e tij për tu mbrojtur në heshtje, gjykata fillimisht e ka pyetur palët se a kanë ndonjë proppzim shtese ku palët njëzëri kanë deklaruar së nuk kanë propozime shtese në lidhje me procedurën e të provuarit.

Pas kësaj, palët janë pyetur dhe kanë deklaruar së nuk ka nevojë për seancën e posaçme për matjen e dënimit, dhe se për rrethanat lehtësuese dhe rënduese do të deklarohen në fjalën përfundimtare, dhe për këtë gjykata ka konstatuar së ka përfunduar procedura e të provuarit dhe ka ftuar palët në dhënien e fjalës përfundimtare konform nenit 350 të KPPRK-së. Në lidhje me fjalën përfundimtare, e sipas kërkesës së Prokurores, seanca është ndërprerë me qëllim të përgatitjes së fjalës përfundimtare.

Mirëpo, Prokurorja e Shtetit, pas përfundimit të procedurës së provave, e para fjalës përfundimtare kërkoi që gjykata si provë të administrojë procesverbalin e marrjes në pyetje për të dyshuarin H. H. ne polici me dt. 25.08.2022 dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit H. H. ne Prokurori me dt. 25.10.2022.

Mbrojtësi dhe i pandehuri kanë kundërshtuar një propozim të tillë meqenëse neni 119 të KPPRK-së nuk lejon përdorimin si provë në shqyrtimin gjyqësor të deklarimeve të mëhershme sepse ato mund të përdoren vetëm për marrjen të tërthortë në pyetje por jo edhe si provave në shqyrtimin gjyqësor.

Pas kësaj, gjykata ka refuzuar propozimin e Prokurores së Shtetit për administrimin e provave të propozuara dhe atë procesverbalin e marrjes në pyetje për të dyshuarin H. H. ne polici me dt. 25.08.2022 dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit H. H. ne Prokurori me dt. 25.10.2022.

Këtë vendim gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 346 të KPPRK-së, pasi që është përfunduar procedura e të provuarit, e po ashtu lidhur edhe me nenin 119 par. 2 të KPPRK-së ku përcaktohet së procesverbali mbi marrjen në pyetje në procedurën paraprake nuk mund të përdoret si prove e drejtpërdrejte gjatë shqyrtimit kryesor por vetëm mund të përdoren gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje dhe rimarrjes në pyetje, përveç nëse parashihet ndryshe me Kodin.

### **Konkludimet e gjykatës**

Andaj, në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera e në bazë të vlerësimit të tillë, ka gjetur se me asnjë prove bindëse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata po ashtu thekson se prokuroria nuk ka bërë përpjekje siç e obligon neni 7 të KPPRK-së<sup>2</sup>, në rastin konkret, Prokuroria ka dështuar në detyrën e saj, të ashtuquajturën “barrën e provës” (*onus probandi*), që të mbledhë prova të mjaftueshme dhe bindëse se i pandehuri ka kryer veprat

---

<sup>2</sup> Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

penale për të cilat akuzohet, përderisa, gjykata ka obligim ligjor që të vërtetoje gjendjen faktike mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor.

Në lidhje me këtë Gjykata, rikujton një ndër parimet kryesore të procedurës penale **“In dubio pro reo”**, të përcaktuar në nenin 3 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i cili përcakton se *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij”*, ndërsa interpretimi tjetër në lidhje me këtë parim është se *“në dëm të të pandehurit mund të merret një fakt vetëm atëherë ai kur është vërtetuar pa mëdyshje, kur ekzistimi i tij qëndroj jashtë çdo dyshimi”*.

Po ashtu, në këtë drejtim mund të konkludohet se ky parim është një rregull e përgjithshme dhe e pavarur e procedurës penale. Parimi se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, aplikohet në procedurën penale me rastin e zgjidhjes së të gjitha fakteve kontestuese, si të atyre që e rëndojnë të pandehurin, ashtu edhe të atyre që i shkojnë në favor. Prandaj, nga kjo del rregulla se të gjitha faktet që shkojnë në dëm të të pandehurit, duhet të vërtetohen patjetër me bindje të plotë, por nëse nuk mund të vërtetohen kësaj, sepse edhe më tutje mbetet dyshimi për ekzistimin e tyre, merret se ato nuk ekzistojnë. Përkundrazi, për të gjitha faktet që shkojnë në favor të të pandehurit, po qe se paraqiten si të mundshme, e ajo mundëshmëri nuk ka mundur të zëvendësohet me bindje të plotë, duhet të merret patjetër se ekzistojnë.

Po ashtu, paragrafi 2 të nenit 3 të KPPRK-së gjen aplikimin e vet edhe me rastin e aktgjykimit lirues kur nuk është provuar së i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Shkaqet humane dhe të drejtësisë, të mbështetura edhe në dispozitat procedurale të sipërpërmendura, na udhëzojnë ndikojnë në formimin e bindjes së tij që, në rast se mbetet dilema për ekzistimin e faktit juridik relevant, duhet të përcaktohet për zgjidhjen që është më e favorshme për të pandehurin, sepse, në rast lajthitjeje, do t'i shkaktojë të pandehurit dëm apo ndonjë padrejtësi më të vogël.

Andaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të të njëjtave, e në bazë të elaborimeve të lartcekura, gjykata ka ardhur në konstatim se nuk është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale, ashtu siç është bërë përshkrimi faktik në dispozitivin të këtij aktgjykimi, për veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armeve apo materialeve plasëse” nga neni 364 par.1 të KPRK-së

Ashtu siç është potencuar më sipër, gjykata aktgjykimin e vet e mbështet vetëm në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Andaj, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar, kjo Gjykatë nuk mundi të vërtetoje përtej dyshimit mirë të bazuar se këtu i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Pretendimet e Prokurorisë nuk u provuan me asnjë prove të vetme, andaj gjykata të njëjtin konform nenit 363 par 1. nën par. 1.3 të KPPRK-së<sup>3</sup>, e në mungesë të provave, e ka liruar nga akuza dhe për të njëjtin ka marrë aktgjykim lirues.

<sup>3</sup> *Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse: nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet”*

### ***Përfundimi***

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par. 1, të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë dhe në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PKR Nr. 12/23 dt. 30.06.2023**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

\_\_\_\_\_  
**Teuta Spahija**

**Kryetari i trupit gjykues,**

\_\_\_\_\_  
**Dr.sc.Murat Hulaj**

**KESHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.